



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 13356 Prot.

Shkodër, më 31.7.2019

Lënda: Informacion për procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr 13216/1 datë 10.07.2019, administruar në Bashkinë Shkodër me datë 22.07.2019, ka dërguar udhëzimin plotësues nr. 20 datë 10.07.2019 "Për përgatitjen e buxhetit vendor".

Në këtë udhëzim cilësohet:

- Parashikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore do të mbështetet në legjislacionin aktual në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, si dhe në ligjin nr.68/2017 datë 27.04.2018 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".
- Transferat e pakushtezuar sektoriale për vitin 2020, do të jete në përputhje me nivelin e financimit të miratuar në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2020-2022 .
- Formula, kriteret dhe koeficientet e formulës së shpërndarjes së transfertes së pakushtezuar për vitin 2020 do të jenë ato të vitit 2019.
- Niveli i transfertes së pakushtezuar dhe i transfertes së pakushtezuar sektoriale për vitet 2020-2022, (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në pushtetin vendor deri në vitin 2019. Për transferimin e funksioneve që mund të behen në të ardhmen niveli i transfertes së pakushtezuar/pakushtezuar sektoriale do të shtohet në varesi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe fatures financiare perkatese.
- Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2020-2022, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022. Ai pasqyron parashikime të treguesve ekonomik dhe financiar të buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësime të burimeve që njësi e vetëqeverisjes vendore do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.

Në kushtet kur Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2020-2022, mbetet i njëjtë sin ë fazën e projektit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, Grupi i Menaxhimit Strategjik, në mbledhjen e datës 26 Korrik 2019, në mbeshtetje te nenit 37 te ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” vendosi që tavanet përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, të jenë tavanet e miratura me VKB nr 24, datë 18.04.2019 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të PBA 2020-2022 të bashkisë Shkodër”, sipas projektit të parë të PBA miratuar me VKB nr. 59 date 18.07.2019 “ Per miratimin e projektit te pare te programit buxhetor afatmesem 2020-2022 te Bashkise Shkoder ”.

Duke ju uruar punë të mbarë,

Me respekt,



KRYETAR

Voltana Ademi
Voltana Ademi

Zv. Kryetar

Fabrizio Sheqer

Zv. Kryetar

Edi Sheqer

Zv. Kryetar

Arben Gruz

Drejtorja e Analizës dhe
e Programimit Buxhetor

P/ Edith Dami Adami

Drejtorja e Financës

Bledar Myso

Drejtorja e të Ardhurave

Blendi Gjylbegaj

Drejtorja Juridike

Alfred Lule

Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe
Sportit

Teuzina Hile

Drejtorja e Shërbimeve Publike, Ndjekjes
së Investimeve dhe Infrastrukturës

Alfred Lule

Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit

Kreshnik Kopshtaku

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Andrita Puroj

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP

Alban Selçje

Drejtoria e Turizmit

Gëzhan Hoxhaj

Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi Ndryshe

Mirëza Haxhi

Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit

Filip Dila

Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave

Adela Shllaku

Drejtoria e Studimeve, Planifikimit, Koordinimit të Investimeve

Alban Kodra

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Ridvan Sokoli

Policia Bashkiake

Anton Hoxhaj